



АГЕНЦИЈА ЗА СТРАНСКИ ИНВЕСТИЦИИ И ПРОМОЦИЈА НА ИЗВОЗОТ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
AGJENCIA PËR INVESTIME TË HUAJA DHE PROMOVIMIN E EKSPORTIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bazuar në nenin 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18 dhe "Gazeta zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 143/19 dhe 14/20) dhe nenit 9 pika 6 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për investime të huaja dhe promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.57/10, 36/11, 41/14 dhe 64/18), u.d Drejtori i Agjencisë për Investime të Huaja dhe Promovimin te Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sjellë:

RREGULLORE

për ndryshimin e Rregullores për sistemimin e vendeve të punës në Agjencinë për investime të huaja dhe promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 1

Me këtë rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për investime të huaja dhe promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 01-866/1 nga data 11.09.2020 dhe 02-759/1 nga 05.07.2021.

Neni 2

Në kapitullin IV PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR INVESTIME TË HUAJA DHE PROMOVIMIN E EKSPORTIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, Në Sektorin për mbështetje dhe promovim të aktiviteteve eksportuese, në Departamentin për planifikim, hulumtim dhe zhvillim, në vendin e punës me "Numri i serisë 49", kodi UPR 01 01 B03 000, titulli i punës "Bashkëpunëtor për kërkimin e tregut", në rubrikën "Lloji i arsimit" ndryshon dhe shkruhet: "Shkencat organizative dhe menaxhmenti (menaxhimi)".

Neni 3

Në kapitullin IV PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR INVESTIME TË HUAJA DHE PROMOVIMIN E EKSPORTIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT në Sektorin e Shërbimeve të Investitorëve dhe Përkrahjes Pas Investimeve, në Departamentin e Shërbimeve të Investitorëve, në postin me Numër Serik "62" kodi UPR



АГЕНЦИЈА ЗА СТРАНСКИ ИНВЕСТИЦИИ И ПРОМОЦИЈА НА ИЗВОЗОТ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
AGJENCIA PËR INVESTIME TË HUAJA DHE PROMOVIMIN E EKSPORTIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

01 01 B04 000, titulli i punës “Bashkëpunëtor i ri për kontakt fillestar me investitorë potencial dhe analizë raportesh”, në rubrikën “Lloji i arsimit” ndryshohet si: “Shkencat organizative dhe menaxhmenti (menaxhimi)” .

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të zbatohet pas pëlqimit të marrë nga Ministria e Shoqërisë Informativë dhe Administratës.

Agjencia për investime të huaja dhe
promovimin e eksportit të
Republikës së Maqedonisë së Veriut

u.d. Drejtori
Dejan Pavleski

Nr. ___ 2021